REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	**07.08.2017**
REFERENCË	
PËR:	**z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan**
CC:	**z. Sefer Tasholli, Nënkryetar i Komunës në Lipjan**
NGA:	**z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan**
LËNDA:	**Raport i punës - Muaji Korrik 01.07.2017–31.07.2017**

DKA edhe gjatë muajit Korrik ka realizuar punë dhe detyra të ndryshme:

Ka përfunduar trajnimi për mësimdhënësit parafillor, klasa e parë, klasa e gjashtë dhe klasa e dhjetë të cilët do të fillojnë zbatimin e kurrikulit të ri nga muaji shtator.

Fillimi i përgatitjeve administrative-teknike për testin e maturës, afati i gushtit.

Shpallja e konkursit të rregullt për stafin arsimor.

Kërkesë Departamentit të DPU-së për:

- Caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e shkollës së re Profesionale në lokacionin ekzistues të SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan dhe
- Hartimin e detyrës projektuese për objektin e Çerdhës në Lipjan.

Kërkesë Departamentit të Prokurimit për zhvillimin e procedurës për :

- Furnizimi me dokumentacion pedagogjik (ditarë, fletore pune, libra amë)
- Furnizimi me dru dhe thëngjill për shkollat
- Transportin e nxënësve Zllakuqan-Ribar, Bregu i Zi-Bujan

Përfundimi i korrje-shirjeve të grurit në SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan (Ekonominë Bujqësore).

Nënalokimi në kategorinë: Paga, Mallra&Shërbime dhe Komunali.

Zotimi i mjeteve në kategorinë: Mallra&Shërbime dhe Komunali.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime - kthim nga lehonia, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim - skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.